



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Rahovec

Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR DRAFT STATUTIN E QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE NË RAHOVEC

	REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO ADMUNA RAHOVEC/OPŠTINA GRAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSIEDNIA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR'S CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No <u>1049</u> Nr. i faq/Br.str/No.pg <u>269</u>		
Data/Datum/Date <u>24 / 09 / 2021</u>		
RAHOVEC / GRAHOVAC		

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Në bazë të nenit 68 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 17, 18 19, 20, 21, 22 dhe nenit 92 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna si dhe vendimit të miratuar nga Kuvendi 01 Nr. 215/21 të dt. 29.06.2021, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale organizon:

KONSULTIM PUBLIK

Lidhur me Draft Statutin për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Rahovec

Njoftimi për organizimin e konsultimit publik për Draft Statutin e QKMF-së u publikua me datë: 28.07.2021 në ueb faqen e komunës së Rahovecit, në të dy gjuhët, në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/07/Njoftim-publik-pr-organizimin-e-konsultimit-publik-per-Draft-Statutin-per-Qendren-Krvesore-te-Mjekesise-Familjare-ne-Rahovec.pdf>, në harmoni me afatet ligjore që i përcakton Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna .

Njoftimi përveç që është publikuar në uebfaqe të komunës, në Platformën për Konsultime Publike, në rrjetin social Facebook, njoftimi është dërguar edhe përmes rrjeteve sociale Viber dhe WhatsApp.

- Më datë 28/07/2021, është publikuar njoftimi për mbajtjen e konsultimit publik për : "Draft Statutin për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Rahovec", njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të komunës në këtë vegëza: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/07/Njoftim-publik-pr-organizimin-e-konsultimit-publik-per-Draft-Statutin-per-Qendren-Krvesore-te-Mjekesise-Familjare-ne-Rahovec.pdf> , Draft Statutin për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Rahovec është publikuar në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/07/Draft-Statuti-i-QKMF.pdf> .

Njoftimi dhe dokumenti janë publikuar edhe në Platformën e Konsultimeve Publike në këtë vegëza: <http://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41153> .

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK-DRAFT STATUTI I QKMF-SË

Në të njëjtën datë njoftimi është publikuar në hyrje të objektit të administratës.

Njoftimi dhe dokumenti i Statutit është publikuar në të dy gjuhët Shqip dhe Serbisht.

KONSULTIMI PUBLIK

Më datë: 11/08/2021 është planifikuar të mbahet konsultimi publik në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal. Të pranishëm kanë qenë zyrtarë komunal, por, nuk u mbajtë për shkak të mos pjesëmarrjes së asnjë qytetari e as ndonjë përfaqësuesi të OJQ-ve që veprojnë në komunën e Rahovecit.

Dokumenti i Draft Statutit të QKMF-së ka qenë në konsultim publik nga data: 28.07.2021 deri më: 28.08.2021, por, se në email-et e zyrtarëve që kanë qenë publik dhe që janë caktuar për t'i pranuar komentet apo edhe sugjerimet lidhur me këtë dokument, nuk është pranuar asnjë koment e as ndonjë sugjerim.

Pas përfundimit të të gjitha procedurave të konsultimit publik, dokumenti është dërguar në Ministri të Shëndetësisë dhe se dokumenti i njëjti nuk është kthyer nga ministria për të vazhduar me miratimin e tij nga anëtarët e Kuvendit Komunal.

Për t'i respektuar afatet ligjore jemi obliguar që të përgatisim dhe të publikojmë procesverbalin, kurse informatën shtesë që ka të bëj me miratimin e Statutit do të publikojmë pasi që ky dokument të kaloj në Kuvend.

Blerta Gashi

Zyrtare përgjegjëse për koordinimin e konsultimeve publike